

MBI PËRHAPJEN DHE DISA KARAKTERISTIKA TË *ACIS IONICA* NË SHQIPËRI

LEFTER KASHTA, ALFRED MULLAJ, JULIAN SHEHU

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Qendra Kërkimore e Florës
dhe Faunës

e-mail: leka.kashta@yahoo.com

Përmbledhje

Acis ionica Bareka, Kamari & Phitos, e njohur si një specie endemike e bregdetit të Jonit, me përhapje në Greqinë perëndimore dhe në një zonë të kufizuar pranë qytetit të Vlorës në Shqipëri, është përshkruar kryesisht nga bimët e mbledhura në Greqi. Ky punim paraqet të dhëna që zgjerojnë arealin e përhapjes të *A. ionica* në Shqipëri dhe krahasuar me tipin, evidenton disa ndryshime që lidhen me tiparet morfologjike, numrin e luleve, madhësinë e farave dhe kohën e lulëzimit.

Fjalë kyçe: *Acis ionica*, Shqipëri, përhapje, të dhëna morfologjike.

Abstract

Acis ionica Bareka, Kamari & Phitos, known as an endemic species of the Ionian coast, distributed in western Greece and in a limited area near the city of Vlore in Albania, has been described mainly from plants collected in Greece. This paper provides data expanding the range of *A. ionica* in Albania and highlights some differences in morphological characteristics, number of flowers, seed size and flowering time compared to the type.

Key words: *Acis ionica*, Albania, distribution, morphological data.

Hyrje

Acis ionica Bareka, Kamari & Phitos është bimë e familjes *Amaryllidaceae* e përhapur në Greqinë perëndimore dhe në Shqipërinë jug-perëndimore. Bregdeti jonian përfaqëson arealin më lindor të njohur deri tani, të përhapjes të specieve të gjinisë *Acis* (Bareka *et al.*, 2006).

Në Greqi (ishulli i Qefalonisë) kjo bimë është gjetur që në vitin 1882 nga botanisti gjerman T. Heldreich e identifikuar si *Leucojum autumnale* L. dhe më vonë si *Leucojum valentinum* Pau (Damboldt & Phitos, 1975), që njihet si bimë endemike e Spanjës (Bareka *et al.*, 2006). Një bimë e ngjajshme u gjet edhe në shkëmbinjtë bregdetarë në jug të qytetit të Vlorës, por duke u nisur nga disa ndryshime në tiparet morfologjike, krahasuar me bimët e Qefalonisë, ajo u konsiderua si subspecie e re dhe u emërtua nga botanistët shqiptarë si *Leucojum valentinum* subsp. *vlorense* (Paparisto & Qosja, 1983). Në vitin 2004, duke u mbështetur në materialin e mbledhur në Greqi dhe në Shqipëri, kjo bimë u raportua si specie e re për shkencën me emrin *Leucojum ionicum* Kit Tan, Mullaj, Sfikas & Strid (Tan *et al.*, 2004). Dy vjet më vonë, bazuar në klasifikimin filogjenetik të propozuar nga Lledó & *et al.* (2004), që përputhet edhe me të dhënat morfologjike, ekologjike dhe citologjike, Bareka *et al.* (2006) e transferojnë specien në gjininë *Acis*, duke i dhënë

emrin e pranuar aktualisht *Acis ionica*. Së fundmi Strid (2019) e konsideron *Acis ionica* sinonim heterotipik të *Leucojum ionicum* dhe e riemërton *Acis orientalis*, por ky emër konsiderohet jo legjitim (Govaerts *et al.*, 2021).

Acis ionica së bashku me *A. valentina* (Pau) Lledó, A.P.Davis. & M.B.Crespo, *A. nicaeensis* Lledó, A.P.Davis. dhe *A. fabrei* (Quézel & Girerd) Lledó, Davis. & Crespo, përbëjnë një grup monofiletik (Lledó *et al.*, 2004; Bareka *et al.*, 2006) dhe janë të gjitha specie endemike lokale: *A. nicaeensis* dhe *A. fabrei* të Francës jug-lindore (Diadema *et al.*, 2007), *A. valentina* e Spanjës lindore dhe *A. ionica* e Greqisë perëndimore dhe Shqipërisë jug-perëndimore. Ato formojnë dy çifte taksash me të njëjtin numër kromozomesh, dy të parat me $2n=16$, ndërsa dy të tjerat me $2n=18$, dëshmi që tregon se këto çifte duhet të kenë origjinën nga copëtimi i arealit të një paraardhësi të përbashkët të përhapur gjerësisht (Casazza *et al.*, 2016). *A. ionica* përfshihet në Listën e Kuqe të bimëve të Shqipërisë si specie e kërcënuar (CR A1c) (Urdhër 1280, 2013). Në këtë punim paraqiten përhapja aktuale e *A. ionica* në Shqipëri si dhe disa ndryshime nga tipi në lidhje me përmasat e tipareve morfologjike dhe numrin e luleve në kërcellin lulor.

Materiali dhe metodat

Grumbullimi i materialit bimor dhe vrotimet në terren janë realizuar gjatë disa ekspeditave të kryera në stinën e vjeshtës në periudhën 2009-2015. Vrotimet dhe matjet në lidhje me tiparet morfologjike si gjatësia dhe trashësia e kërcellit lulor, gjatësia dhe gjerësia e gjetheve, numri i luleve për kërcell lulor dhe gjatësia e farave, janë kryer në bimë të gjalla në terren dhe në disa prej tyre të rritura në vazo. Të dhënat tona janë krahasuar me tipin, sipas përshkrimit të dhënë nga Bareka *et al.* (2006) si dhe të autorëve të tjerë (Paparisto & Qosja, 1983; Tan *et al.*, 2004). Një pjesë e materialit të mbledhur është depozituar pranë Herbarit Kombëtar (TIR).

Resultate dhe diskutime

Nga studimi i bimëve të mbledhura përgjatë bregdetit shqiptar kemi venë re se ka disa ndryshime nga tipi i përshkruar nga Bareka *et al.* (2006), që lidhen me tiparet morfologjike, numrin e luleve, madhësinë e farave, periudhën e lulëzimit si dhe me përhapjen në Shqipëri (Tab. 1). Këto konstatime, një pjesë e të cilave janë të ngjajshme me ato të botanistëve shqiptarë Paparisto & Qosja (1983), si dhe disa të dhëna nga Tan *et al.* (2004), na nxitën të paraqesim edhe ne rezultatet e vrotimeve tona.

Të dhëna mbi përmasat e kërcellit lulor dhe të gjetheve: Sipas të dhënave tona, gjatësia e kërcellit lulor përgjithësisht përputhet me tipin (8-20 cm), por në mjaft raste e kalon pak atë (26-36 cm) dhe më rrallë shkon deri në 40cm. Trashësia e kërcellit lulor (scapus) pothuajse në të gjitha rastet e matura nga ne është më e madhe se tipi (shih tab. 1), në mjaft raste është sa dyfishi (2.5-3 mm) dhe më rrallë, pak i shtypur, rreth 4 mm i gjerë (Fig. 1A). Edhe sipas Paparisto & Qosja (1983) kërcelli lulor është më i trashë, me diametër 2-5 mm. Në këtë drejtim bimët tona ngjajnë më shumë me *Acis valentina* të

Spanjës. Vlen të theksohet se Bareka *et al.* (2006) shkruajnë se një nga tiparet dalluese të *A. ionica* nga *A. valentina*, është se e para ka kërcell lulor të hollë (0.8-1.2 mm), ndërsa e dyta ka kërcell më të fuqishëm (2-3 mm).

Sipas literaturës gjethet janë gjatësore e të holla, me përmasa 12-22 cm x 2-3 mm (Bareka *et al.*, 2006), (5-)10-20(-24) cm x 1-2.5(-3) mm (Tan *et al.*, 2004). Në bimët tona ne kemi matur shpesh gjethë me gjerësi 3 mm, por edhe 4 mm (Fig. 1B) dhe në ndonjë rast edhe 5 mm të gjera dhe deri në 40cm të gjata, përmasa të ngjajshme me ato të Papparisto & Qosja (1983).




Figura 1. A: prerje tërthore e kërcellit lulor; B: gjerësia e gjethes.

Të dhëna mbi organet e riprodhimit dhe kohën e lulëzimit: Sipas përshkrimit të tipit kërcelli lulor (scapus) ka një lulesë të përbërë nga dy deri në katër lule, ndonjëherë vetëm një ose deri në gjashtë (Bareka *et al.*, 2006).

Sipas Tan *et al.* (2004) ka (1-)3-5(-7) lule për lulesë, kurse sipas Papparisto & Qosja (1983) (2)4-7(8). Ne kemi gjetur, sipas popullatave, (1-)2-3(-4) lule në Orikum, Karaburun, Porto Palermo; (1-)2-4(-6) lule në Dukat, kthesat e Llogarasë, Palasë, Manastir; (2-)4-7(-8) lule në Vlorë dhe (3-)5-8(-12), në Dhërmi (Fig. 2, 3).



Figura 2. Kërcell lulor me 1 lule (Porto Palermo, 10.09.2013) dhe me 4-6 lule (Dukat, 10.09.2013).

Në lidhje me kohën e lulëzimit, raportohet periudha shtator-tetor (Bareka *et al.*, 2006) dhe shtator-nëntor (Tan *et al.*, 2004). Në Shqipëri, sipas vrojtime tona, bima lulëzon më herët, në muajt gusht-shtator, periudhë që përputhet me të dhënat e Papparisto & Qosja (1983)



Figura 3. *Acis ionica*, majtas - holotipi i depozituar në UPA, Greqi (Bareka *et al.* 2006), djathtas - bimë me 6-8 lule (Dhërmi, 9.09.2009) dhe me 12 lule (në bimë nga Dhërmiu, rritur në vazo, 28.08.2013).

Sipas literaturës gjatësia e farave është 2.5-3 mm (Bareka *et al.*, 2006; Tan *et al.*, 2004). Në bimët tona ato zakonisht janë rreth 3 mm, por në Dhërmi kemi matur fara deri 3.5 mm dhe 4 mm të gjata (Fig. 4).




Figura 4. *Acis ionica* e frutifikuar. A: në Vlorë (8.10.2012) dhe B: në Dhërmi (13.09.2010); C, D: fruta dhe fara në bimë nga Dhërmiu, rritur në vazo, tetor 2010.

Sipas Paparisto & Qosja (1983), në popullatën e Vlorës janë gjetur fara edhe më të mëdha, 3-4(5) mm të gjata.

Tabela 1. Disa tipare të *Acis ionica* sipas të dhënave të autorëve të ndryshëm

	Paparisto & Qosja, 1983	Tan <i>et al.</i> , 2004	Bareka <i>et al.</i> , 2006	Të dhënat tona
Kërçelli lutor (Scapus)	20-25 cm, jo hollak, i plotë	10-30(-40) cm, i hollë, i drejtë, i zbrazët	8-20(-25) cm, i hollë, i drejtë, i plotë	14-36 (-40) cm, jo hollak, i drejtë, i plotë
Kërçelli lutor	Me diametër 2-5 mm		Me diametër 0.8-1.2 mm	Me diametër 2.5-3 (-4) mm
Gjethet	Deri 40 cm të gjata	(5)10-20(-24) cm × 1-2.5(-3) mm	12-22 cm × 2-3 mm	Deri 4 (-5) mm të gjera
Lulet	(2)4-7(8)	(1-)3-5(-7)	(1-)2-4(-6)	(1-) 3-7 (-12)
Farat	3-4(5) mm	2.5-3 mm	2.5-3 mm	3-3.5 (-4)
Lulëzimi	Gusht-Shtator	Shtator-Nëntor	Shtator-Tetor	Gusht-Shtator
Lartësia	Nuk jepet	0-330 m	3-350(-450) m	10-350 (-490) m
Përhapja në Shqipëri	Në afërsi dhe në jug të qytetit, përgjatë rrugës Vlorë-Jonufër	Shqipëria jug-perëndimore afër Vlorës	Shqipëria jug-perëndimore afër Vlorës	Gjetur në 12 lokalitete nga Vlora deri në Porto Palermo

Duhet theksuar se përshkrimi i specisë nga Bareka *et al.*, (2006) mbështetet kryesisht në bimët e mbledhura në Greqi, ndërsa materiali nga Shqipëria ka qenë i kufizuar vetëm në bimë të mbledhura nga S. Gjini në jug të qytetit të Vlorës (Bareka *et al.*, 2006).

Të dhëna mbi përhapjen e specisë në Shqipëri: Fillimisht, kur u përshkrua si *Leucojum valentinum* ssp. *vlorense*, njohja për përhapjen e kësaj bime ishte e kufizuar në jug të qytetit, përgjatë rrugës Vlorë-Jonufër (Paparisto & Qosja, 1983). Vite më vonë u raportua një vendgjetje e re pranë kishës së vjetër të Orikumit (Xhulaj & Mullaj, 2001).

Ne e kemi mbledhur *A. ionica* në lokalitetet e mëposhtme (për praninë e specisë në lokalitetin 2, kemi njoftim personal nga kolegu ynë P. Hoda).

1. Vlorë, Kala: 40°24'46.10" N, 19°28'49.87" E
2. Karaburun, Shën Jan: 40°25'52.97" N, 19°20'18.70" E
3. Karaburun, Ravenë: 40°20'44.68" N, 19°22'21.50" E
4. Orikum, Kisha e Marmiroit: 40°18'13.79" N, 19°26'48.27" E
5. Dukat 1: 40°14'27.78" N, 19°33'1.67" E
6. Dukat 2: 40°13'56.38" N, 19°33'33.26" E

7. Fajeo, kthesat e Llogarasë: 40°11'4.75" N, 19°36'22.60" E
8. Ura e Palasës: 40°10'32.00" N, 19°36'24.20" E
9. Palasë, fshat: 40° 9'45.65" N, 19°37'33.63" E
10. Dhërmi, Potam: 40° 9'20.05" N, 19°38'22.34" E
11. Manastiri Shën Theodorit: 40° 7'48.64" N, 19°39'28.63" E
12. Porto Palermo: 40° 3'2.95"N19°47'58.67"E



Figura 5. *Acis ionica*: majtas, përhapja e përgjithshme (sipas Bareka *et al.*, 2006); djathtas, përhapja në Shqipëri (sipas të dhënave tona).

Nga të dhënat e mësipërme shihet qartë se areali i përhapjes i *A. ionica* në Shqipëri zgjerohet dukshëm, me një shtrirje që shkon nga Vlora deri në Porto Palermo të Himarës (Fig. 5) dhe ndoshta edhe më në jug. Lartësia më e madhe ku është gjetur specia është 490 m mbi nivelin e detit, në kthesat e Llogarasë, pak më lart nga sa është raportuar më parë nga Bareka *et al.* (2006).

Të dhënat e paraqitura në këtë punim mendojmë se plotësojnë dhe saktësojnë më tej karakteristikat e *Acis ionica* dhe përhapjen e përgjithshme të saj.

Literatura

Bareka P., Kamari G. & Phitos D. (2006): *Acis ionica* (Amaryllidaceae), a new species from the Ionian area (W Greece, S Albania). – Willdenowia **36** (special issue): 357-366

Casazza G., Barberis G., Guerrina M., Zappa E., Mariotti M., Minuto L. (2016): The plant endemism in the Maritime and Ligurian Alps. - Biogeographia – The Journal of Integrative Biogeography 31: 73–88

Damboldt J. & Phitos D. (1975): Die Karyosystematik der Gattung *Leucojum* L. (Amaryllidaceae) in Griechenland. - Pl. Syst. Evol. **123**: 119-131

- Diadema K., Médail F., Castagné H., Affre L., Roux J.-P. & Bretagnolle F. (2007): Écologie, distribution et morphologie comparées des nivéoles de Nice (*Acis nicaeensis*) et de Fabre (*Acis fabrei*), Alliaceae endémiques des Alpes maritimes et de la Nesque (Vaucluse), - Acta Botanica Gallica: Botany Letters **154**(4): 619-634
- Govaerts R., Nic Lughadha E., Black N., Turner R. & Paton A. (2021): The World Checklist of Vascular Plants, a continuously updated resource for exploring global plant diversity. <https://doi.org/10.1038/s41597-021-00997-6> Scientific Data 8: 215. [Cited as *Acis ionica*.]
- Lledó M.D., Davis A.P., Crespo M.B., Chase M.W. & Fay M.F. (2004): Phylogenetic analysis of *Leucojum* and *Galanthus* (*Amaryllidaceae*) based on plastid *matK* and nuclear ribosomal spacer (ITS) DNA sequences and morphology. - Pl. Syst. Evol. 246(3-4): 223-243
- Paparisto K. & Qosja Xh. (1983): Një nënspacie e re e gjinisë *Leucojum* në Shqipëri, *L. valentinum* Pau subsp. *vlorense* (subsp. nov.). - Bul. Shkencat Nat. **1**: 93-100
- Strid A. (2019): *Acis orientalis*: a new name for *Leucojum ionicum* (*Amaryllidaceae*). - Phytologia Balcanica **25**(1): 79 – 80, Sofia
- Tan Kit, Mullaj A., Sfikas G. & Strid A. (2004): An autumn-flowering *Leucojum* (*Amaryllidaceae*) in South Albania and Western Greece. - Fysis [Journal of the Hellenic Society for the Protection of Nature] **107**(Oct–Dec): 39-42
- Urdhër 1280 (2013): Urdhër për miratimin e Listës së Kuqe të Florës dhe Faunës së egër. Ministria e Mjedisit. <http://extwprlegs1.fao.org/docs/pdf/alb144233.pdf>
- Xhulaj M. & Mullaj A. (2001): Vendgjetje e re për bimën endemike shqiptare *Leucojum valentinum* subsp. *vlorense* Paparisto & Qosja - Studime Biologjike, **5-6**: 510-512